

*Banka e Shqipërisë*

***UDHËZUES***

***MBI RREZIQET FINANCIARE TË LIDHURA ME KLIMËN DHE  
MJEDISIN***

Gusht 2024

## PËRMBAJTJA

<i>1. TË PËRGJITHSHME</i>	<i>3</i>
<i>1.1 Objektivat</i>	<i>3</i>
<i>1.2 Subjektet</i>	<i>3</i>
<i>1.3 Fusha e zbatimit</i>	<i>3</i>
<i>2. PËRKUFIZIME</i>	<i>4</i>
<i>3. PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE PËR STRATEGJINË DHE MODELIN E BIZNESIT</i>	<i>6</i>
<i>4. PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE PËR QEVERISJEN E BRENDSHME</i>	<i>8</i>
<i>5. PRITSHMERITE MBIKËQYRËSE PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT</i>	<i>10</i>
<i>5.1 Sistemi i Administrimit të rrezikut</i>	<i>10</i>
<i>5.2 Administrimi i rrezikut të kredisë</i>	<i>11</i>
<i>5.3 Administrimi i rrezikut operacional</i>	<i>14</i>
<i>5.4 Administrimi i rrezikut të tregut</i>	<i>16</i>
<i>5.5 Administrimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit</i>	<i>17</i>
<i>5.6 Analiza e skenarëve dhe stress test-et</i>	<i>18</i>
<i>6. PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT</i>	<i>18</i>
<i>7. MODELET E RAPORTIMIT</i>	<i>19</i>
<i>8. ANEKSE</i>	<i>21</i>
<i>8.1 Aneksi 1: Shembuj të faktorëve që nxisin rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin dhe si ato ndikojnë në kategoritë e tjera ekzistuese të rreziqeve.</i>	<i>21</i>
<i>8.2 Aneksi 2: Vetëvlerësimi: formulari dhe udhëzime</i>	<i>23</i>
<i>8.3 Aneksi 3. Plani i veprimit: formularë dhe udhëzime</i>	<i>26</i>
<i>8.4 Aneksi 4. Monitorimi/Ndekja e planit të veprimit: formular dhe udhëzime</i>	<i>28</i>

## 1. TË PËRGJITHSHME

### 1.1 Objektivat

Objekti i këtij dokumenti është të përcaktojë pritshmëritë e Bankës së Shqipërisë në drejtim të:

- a) orientimit, përgatitjes së sektorit bankar për vlerësimin, matjen, administrimin dhe kontrollin e rreziqeve financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin;
- b) orientimit të sektorit bankar për të adresuar në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin, gjatë vlerësimit dhe zbatimit të strategjisë së biznesit në qeverisjen e brendshme dhe administrimin e rreziqeve;
- c) rritjes së kapaciteteve njerëzore për tu angazhuar në analizën e ndryshimeve klimatike;
- d) përcaktimit të modeleve të raportimit mbi vetëvlerësimet e bankave lidhur me përgatitjen e tyre për kalimin drejt një qasjeje mjedisore më miqësore, si dhe drejt përmbushjes së pritshmërive mbikëqyrëse;
- e) arritjes së një transparence më të madhe në kohë dhe publikim të informacionit dhe të dhënave të mjaftueshme që kanë lidhje me rreziqet klimatike dhe mjedisore.

### 1.2 Subjektet

Ky dokument u drejtohet të gjitha bankave që janë licencuar dhe ushtrojnë aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### 1.3 Fusha e zbatimit

Rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe sistemi bankar luan një rol kyç në këto ndryshime, pasi shërben si kanalizues i flukseve të kapitalit drejt një ekonomie më të qëndrueshme. Në këtë proces, ndryshimet klimatike dhe tranzicioni drejt aktiviteteve të qëndrueshme përbëjnë burim rreziku për bankën.

Ky dokument përcakton kërkesa të përgjithshme për bankat, bazuar në rregulla dhe parime, për administrimin e sigurt dhe të kujdesshëm të rreziqeve financiare të lidhur me klimën dhe mjedisin. Këto kërkesa vijnë në formën e pritshmërive mbikëqyrëse për bankat, nëpërmjet të cilave synohet të lehtësohet tranzicioni i bankave drejt aktiviteteve të qëndrueshme dhe t'i përgatisë ato për

ndryshimet e ardhshme rregullative lidhur me rreziqet e lidhura me klimën. Bankat janë të lira të zgjedhin dhe përdorin metodat e tyre, brenda kuadrit ligjor dhe rregullativ ekzistues, për të identifikuar rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike dhe të mjedisit, si nxitës të kategorive ekzistuese të rrezikut.

Bankat integrojnë rreziqet klimatike në kuadrin e përgjithshëm të administrimit të rrezikut, për të shmangur humbjet e papritura. Udhëzuesi jep udhëzime lidhur me vlerësimin strategjik të rreziqeve të sipërpërmendura, qeverisjen dhe organizimin e brendshëm në administrimin e tyre.

Bankat përshtasin rekomandimet e këtij udhëzuesi referuar natyrës dhe modelit të tyre të biznesit dhe në përputhje me shërbimet që ofrojnë, duke përfshirë specifikat që rrjedhin nga struktura organizative, madhësia dhe kompleksiteti i bankës, profili i rrezikut dhe ekspozimi ndaj rrezikut.

Megjithëse ky udhëzues fokusohet më shumë në rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin, është e rëndësishme të theksohet se këto zhvillime ofrojnë gjithashtu mundësi potenciale biznesi për bankat, të cilat mund të përfshijnë zhvillimin e formave të reja, madje edhe inovative të financimit.

## 2. PËRKUFIZIME

Termet e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG)” janë mundësitë për të pësuar humbje, kosto shtesë, mosrealizim të të ardhurave të planifikuara. Faktorët aktualë ose të ardhshëm të ESG-së ndikojnë në performancën financiare, reputacionin e bankës dhe marrëdhëniet e saj me palët e treta (investitorë, klientë, organet rregullatorë).
- b) “Faktorët ESG” i referohen ngjarjeve mjedisore, sociale ose të qeverisjes që janë objekt i pasigurisë dhe mund të kenë një ndikim pozitiv ose negativ në performancën financiare ose aftësinë paguese të një njësie ekonomike, sovrani ose individ.
- c) “Objektivat strategjike dhe/ose limitet e lidhura me rreziqet klimatike dhe mjedisore”, janë përcaktime që synojnë administrimin e ekspozimit të një banke ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, në periudha kohore afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.
- d) “Rreziqet e lidhura me klimën” janë rreziqet financiare që shfaqen nga ekspozimi i bankave ndaj kundërpartive që mund të kontribuojnë ose të ndikohen nga ndryshimet klimatike (të tilla si dëmet e shkaktuara nga ngjarjet ekstreme të motit ose një rënie në vlerën e aseteve në sektorë të kategorizuar me emetim të lartë karboni).
- e) “Rreziqet e lidhura me mjedisin” janë rreziqet financiare që shfaqen nga ekspozimi i bankave ndaj kundërpartive që potencialisht mund të shkaktojnë ose të ndikohen nga degradimi i mjedisit (të tilla si ndotja e ajrit, ndotja e ujit, mungesa e ujit të ëmbël, ndotja e tokës dhe shkretimi, humbja e biodiversitetit dhe shpyllëzimi) dhe humbja e shërbimeve të ekosistemit.
- f) “Rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin” mund të shfaqen si rreziqe të tranzicionit ose si rreziqe fizike.
- g) “Rreziqet e tranzicionit” i referohen rreziqeve për bankën që rrjedhin nga kalimi në një ekonomi me emetim të ulët të karbonit dhe rezistente ndaj klimës, në të cilat përfshihen:

- i. “Rreziqet nga politikat/ rreziqet rregullatore”, për shembull ato që rrjedhin nga kërkesat e efikasitetit të energjisë, mekanizmat e çmimit të karbonit që rrisin çmimin e lëndëve djegëse fosile, ose politikat që promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokës.
  - ii. “Rreziqet teknologjike”, për shembull kur një teknologji me një ndikim më pak të dëmshëm në klimë zëvendëson një teknologji me një ndikim më të dëmshëm në klimë.
  - iii. “Rreziqet e tregut”, për shembull nëse preferencat dhe kërkesat e klientëve dhe konsumatorëve të korporatave zhvendosen drejt produkteve dhe shërbimeve më pak të dëmshme për klimën.
- h) “Rreziqet fizike” janë rreziqe për bankën, që vijnë nga pasojat fizike të ndryshimeve klimatike:
- i. “Rreziqet fizike akute” janë ngjarje të papritura të shkurtra dhe të rënda që kanë një ndikim të rëndësishëm negativ, që vijnë nga ngjarje specifike, në veçanti ngjarje të lidhura me motin, si stuhitë, përmbytjet, zjarret ose valët e nxehtësisë, të cilat mund të dëmtojnë prodhimin dhe të ndërpresin zinxhirët ekonomikë.
  - ii. “Rreziqet fizike kronike” janë ato që rezultojnë nga ndryshimet afatgjata të klimës, të tilla si ndryshimet e temperaturës, rritja e nivelit të detit, rënia e burimeve ujore, humbja e biodiversitetit dhe ndryshimet në pjellorinë e tokës.
- i) “Gazrat serë -GS- (Green House Gases - GHG)” janë përbërës të gaztë të atmosferës, si natyrore ashtu edhe antropogjene (të lidhura me njerëzit), të cilët thithin dhe lëshojnë rrezatim në gjatësi vale të caktuara brenda spektrit të rrezatimit termik infra të kuq të emetuar nga vetë sipërfaqja e Tokës, atmosfera dhe retë. Kjo veti shkakton efektin serë. Avulli i ujit (H<sub>2</sub>O), dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O), metani (CH<sub>4</sub>) dhe ozoni (O<sub>3</sub>) janë gazrat kryesorë serë në atmosferën e Tokës.
- j) “Ekonomia e gjelbër (ekonomi me karbon të ulët)” nënkupton një ekonomi me emetim të ulët të karbonit që përdor burimet në mënyrë efikase dhe është në interes të publikut.
- k) “Huadhënia/investimi i gjelbër (termi i gjerë "produkte të gjelbra")” i referohet huadhënies, investimit ose produkteve të tjera financiare të bankës, të cilat varen nga kriteret ekologjike për përdorimin e planifikuar të fondeve, me synimin për të reduktuar efektet negative të aktiviteteve në mjedis apo rreziqet për mjedisin.
- l) “Fasada e gjelbër” (greenwashing) i referohet praktikës së përfitimit të një avantazhi konkurrues të padrejtë në treg duke reklamuar një produkt financiar si të pranueshëm për mjedisin, kur në fakt nuk përmbushen standardet bazë mjedisore.
- m) “Oreksi/toleranca ndaj rrezikut” është niveli i agreguar dhe llojet e rrezikut që banka është e gatshme/në gjëndje të ndërmarrë, brenda kapacitetit të vet të rrezikut, për arritjen e objektivave strategjik të veprimtarisë dhe planit të saj të biznesit.
- n) “Taksonomia” e aktiviteteve ekonomike nënkupton një *sistem klasifikimi* në të cilin mund të përdoret një listë e aktiviteteve ekonomike ekologjikisht të qëndrueshme dhe e pragjeve për të përcaktuar qartë, se cili aktivitet ekonomik është në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm, kontribuon në objektivat mjedisore dhe në parimet e një aktiviteti të qëndrueshëm ekonomik. Taksonomia ndihmon investitorët, emetuesit dhe promovuesit e projekteve të përqendrohen në kalimin drejt një ekonomie më karbon të ulët dhe më efikase

ndaj burimeve dhe rezistente/të qëndrueshme ndaj rrezikut klimatik. Duke qenë se aktualisht nuk ka një taksonomi në fuqi në Shqipëri, bankat do t'i zhvillojnë vetë këto përkufizime dhe do t'i zbatojnë ato për produktet që i'u ofrojnë klientëve të tyre sipas nevojës. Për këto qëllime, banka mund të përdorë përkufizime nga praktikat ndërkombëtare (p.sh. Taksonomia e Bashkimit Evropian<sup>1</sup>) bazuar në parimin e proporcionalitetit. Taksonomia e aplikueshme duhet të jetë në përputhje me natyrën, madhësinë dhe modelin e biznesit të bankës.

### 3. PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE PËR STRATEGJINË DHE MODELIN E BIZNESIT

1. Rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e biznesit të bankave. Banka identifikon rreziqet që vijnë nga ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor në nivel sektorësh kryesorë apo zonash gjeografike si dhe në nivel produktesh e shërbimesh që ofron ose planifikon të ofrojë, duke marrë në konsideratë që disa nga këto rreziqe mund të materializohen gjatë një periudhe kohe afatmesme ose afatgjatë. Për më tepër, duke qenë se ndryshimet në modelin e biznesit kërkojnë kohë për t'u bërë operacionale nevojiten veprime të menjëhershme dhe të përshtatshme edhe në rastet kur çënohet qëndrueshmëria e strategjisë së biznesit në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin mund të ndikojnë, për shembull, në rritjen ekonomike, punësimin ose çmimet e pronave në nivel kombëtar, rajonal ose lokal. Ngjarjet e motit mund të shkaktojnë thatësira ose përmytje që ndikojnë në prodhimin bujqësor të një rajoni, kërkesën për banesa ose në vlerën e kolateralit, në nivel kombëtar, rajonal ose lokal. Paralelisht, konkurrenca ndikohet nga zhvillimi i një tregu financimi të gjelbër dhe preferencat e konsumatorëve zhvendosen nga mallrat dhe shërbimet me emetim të lartë karboni ose ndryshe ndotëse, drejt produkteve dhe shërbimeve me emetim të ulët karboni ose ndryshe "të gjelbra". Në fushën e teknologjisë, bankat që u shërbejnë klientëve në industri me intensitet energjie dhe termocentrale që mbështeten shumë në lëndët djegëse fosile (d.m.th., termocentralet me qymyr) mund t'i shohin klientët e tyre të përballen me kërkesa të konsiderueshme investimesh për të dekarbonizuar përdorimin e tyre të energjisë. Kështu, në identifikimin e rreziqeve, një bankë mund të kategorizojë klientët ose portofolet e saj sipas ekspozimeve ndaj rrezikut klimatik. Për shembull, grupimi gjeografik mund të ndihmojë në identifikimin e ekspozimeve që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të larta fizike, si rreziku i lartë i përmytjeve ose thatësirës. Kategorizimi sektorial mund të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve të tranzicionit, për shembull duke vlerësuar peshën e sektorëve me intensitet të lartë të gazrave serë në portofolin e huadhënies.

2. Rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin e strategjive ekzistuese dhe të ardhshme të një banke. Banka duhet të identifikojë dhe vlerësojë se cilat rreziqe të lidhura me klimën dhe mjedisin janë materiale për strategjinë

<sup>1</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=celex:32020R0852>

e saj të biznesit në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe qëndrueshmërinë e strategjisë të biznesit ndaj këtyre rreziqeve. Periudha kohore është veçanërisht e rëndësishme pasi shumica e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin pritet të shfaqen në terma afatmesëm deri në afatgjatë, zakonisht duke shkuar përtej cikleve të zakonshme të planifikimit të biznesit të bankave.

3. Bazuar në këtë dokument banka dokumenton në mënyrë të plotë proceset me anë të të cilave vlerësojnë rëndësinë e rreziqeve klimatike dhe mjedisore për mjedisin e saj të biznesit.
4. Zbatimi i strategjisë së biznesit të një banke pritet të reflektojë vlerësimin e bankës ndaj ndryshimeve të rëndësishme klimatike dhe rreziqeve mjedisore. Procesi nga banka duhet të jetë i besueshëm duke përcaktuar dhe monitoruar treguesit kryesorë afatgjatë të performancës (këtu e më poshtë: “KPI”), ashtu edhe treguesit kryesor të rrezikut (KRI) të cilët duhet të jenë sasiorë (të matshëm dhe të kuantifikueshëm), kur është e mundur. Në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të veprimtarisë të bankës, këta tregues mund të zhvillohen edhe për linjat e biznesit, klientët dhe produkte të caktuara, aty ku ato janë materiale dhe të rëndësishme.

Treguesit që përcaktojnë një objektiv specifik për kreditë e gjelbra, për shembull, mund të transmetohen në mënyrë hierarkike ose të ndahen në klientë korporatë; individët; aktivitetet e biznesit ose sektorët ekonomikë; llojet e huave (p.sh., kredi konsumatore, hipotekore, linja krediti, etj.); zona gjeografike; etj.

5. Banka merr në konsideratë edhe ndikimin që mund të kenë në mjedis strategjia e zhvillimit dhe modeli i saj i biznesit, për shembull, nëpërmjet matjes dhe kufizimit të emetimeve të gazrave serë (GS) ose efikasitetin e burimeve të portofoleve të saj kryesore, ose që rrjedhin nga aktivitetet e saj. Banka ndërmer hapa për të zbutur rreziqet e tranzicionit, për shembull reduktimin gradual apo edhe me shpejtësi të financimit të aktiviteteve të cilat nuk sigurojnë qëndrueshmëri mjedisore. Praktikë e mirë është zhvillimi i një plani të neutralitetit të karbonit në përputhje me objektivat e qëndrueshërisë klimatike dhe mjedisore (d.m.th., ato të vendosura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar<sup>2</sup>).

Rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin mund të prekin në mënyra të ndryshme rajone të ndryshme, nën-sektorë ekonomikë, huamarrës ose asete. Në dritën e këtyre rreziqeve, objektivat e përgjithshme dhe plani i bankës mund të kenë nevojë të përkthehet në objektiva (ose kufizime) më specifike, duke përfshirë politikat e përjashtimit për financime në rajone të caktuara, nënsektorë ose aktivitete të caktuara (p.sh., sektorë të veçantë ose kundërparti specifike për shkak të prodhimit ndotës).

<sup>2</sup> Kjo duke u përfshirë, por pa u kufizuar në Marrëveshjen e Parisit, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Kontributet e Përcaktuara Kombëtare (NDC), etj.). Këto përpjekje janë gjithashtu në përputhje me objektivin e nenit 2(1)(c) të Marrëveshjes së Parisit<sup>2</sup>. Objektivat e nenit 2(1)(c) të marrëveshjes së Parisit: “të orientosh fluksin e financimeve drejt aktiviteteve me emetimeve të ulta të gazeve serë dhe të zhvillimit rezistent ndaj klimës”. [https://treaties.un.org/doc/Treaties/2016/02/20160215%2006-03%20PM/Ch\\_XXVII-7-d.pdf](https://treaties.un.org/doc/Treaties/2016/02/20160215%2006-03%20PM/Ch_XXVII-7-d.pdf)

6. Banka vlerëson strategjikisht nëse do të zhvillojë produkte të qëndrueshme që konsiderohen të jenë më rezistente ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin. Këto përfshijnë produkte të emërtuara zakonisht si "të gjelbra". Banka mund të përdorë produkte të tilla si një mjet për të arritur objektivat e saj të rrezikut të lidhura me klimën dhe mjedisin dhe të rregullojë modelin e saj të biznesit dhe përbërjen e portofolit. Kur banka që krijon ose planifikon të krijojë produkte të kredisë të qëndrueshme për mjedisin duhet të zhvillojë, si pjesë të politikave dhe procedurave të saj të rrezikut të kredisë, detaje specifike të politikave dhe procedurave të huadhënies për mjedisin, duke mbuluar dhënien dhe monitorimin e këtyre produkteve. Banka pozicionon politikat dhe procedurat e saj të huadhënies për mjedisin brenda kontekstit të objektivave, strategjisë dhe politikës së tyre kryesore në lidhje me financimin e qëndrueshëm. Ajo vlerëson shkallën në të cilën zhvillimi i aktivitetit të qëndrueshëm të huadhënies kontribuon në objektivat dhe/ose limitet e tyre të përgjithshme të lidhura me rreziqet klimatike dhe mjedisore.

Sipas këtij udhëzuesi, objektivat strategjik të lidhura me klimën dhe mjedisin dhe/ose limitet kuptohen si përcaktime që synojnë administrimin e ekspozimit të bankës ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, në periudhat kohore afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Për shembull, banka mund të vendosë objektiva strategjik dhe/ose limite në lidhje me ekspozimet e saj ndaj aktiviteteve ose sektorëve të caktuar ekonomikë. Në të kundërt, objektivat ose limitet që nuk lidhen me qëndrueshmërinë e modelit të biznesit dhe qëllimi i të cilëve nuk është të përmirësojë efektivisht administrimin e bankës për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin, nuk konsiderohen objektiva dhe/ose limite strategjike të lidhur me klimën dhe mjedisin. Më tej, banka duhet të ketë parasysh se vendosja e objektivave strategjik ka të ngjarë të ndryshojë profilin e saj të përgjithshëm të rrezikut, duke rezultuar në nevojën për të rishikuar oreksin e saj ndaj rrezikut.

#### **4. PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE PËR QEVERISJEN E BRENDSHME**

7. Rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin përfshihen në sistemin e qeverisjes së brendshme dhe drejtimin e një banke. Si rrjedhojë, Këshilli Drejtues dhe menaxhimi duhet të kenë njohuri dhe të kuptojnë mjaftueshëm rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin për të siguruar që niveli i rrezikut të ndërmarrë është në përputhje me oreksin dhe strategjinë e rrezikut të bankës, me procedurat dhe politikat e brendshme, dhe se banka është në përputhje me kërkesat ligjore dhe kërkesat rregullative në fuqi për mbikëqyrjen e bankave.

Për shembull, do të konsiderohej praktikë e mirë nëse Këshilli Drejtues merr raporte të rregullta mbi rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin ose informohet rregullisht për to në mbledhjet e tij.

8. Në zbatim të nenit 5 të Rregullores “Për parimet bazë të menaxhimit të bankave” dhe Seksionit II<sup>3</sup> të Udhëzimit “Për qeverisjen e brendshme të bankave”, Këshilli Drejtues i bankës duhet të ketë njohuri, kualifikime dhe eksperiencë të përshtatshme kolektive në lidhje me rreziqet mjedisore dhe ato të lidhura me klimën. Banka siguron që të ketë personel të identifikuar dhe që të ketë ekspertizë për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin dhe që anëtarët e Këshillit Drejtues dhe personeli i dedikuar të njohin rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin e bankës që në fillimin e punësimit të tyre, si pjesë e hyrjes në bord dhe trajnimit për detyrat e tyre.
9. Banka përcakton qartë strukturën e brendshme organizative si dhe përgjegjësitë e secilit funksion dhe punonjës që kryen funksione kontrolli në lidhje me rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin. Këto përcaktime bëhen në përputhje me parimet e përgjithshme të sistemeve të kontrollit të brendshëm sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi dhe përshkruajnë qartë përgjegjësitë, proceset e punës dhe objektivat për këto funksione. Është përgjegjësi e Këshillit Drejtues të sigurojë që përgjegjësitë përkatëse të jenë të qarta, të përcaktuara mirë, të qëndrueshme, të zbatueshme dhe të dokumentuara në mënyrë të plotë.
10. Banka, në përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiave të brendshme për administrimin e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, orientohet sipas opsioneve të mëposhtme:
- krijimin e një njësie organizative ose funksioni të veçantë përgjegjës për administrimin dhe kontrollin e ndryshimeve të rreziqeve klimatike dhe mjedisore. Kur banka krijon një departament ose funksion të veçantë për rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin, pritjet që integrimi i këtij departamenti ose funksioni të veçantë në proceset ekzistuese dhe marrëdhënia e tij me funksionet e tjera, të përcaktohet qartë (ndarja e përgjegjësiave dhe detyrave, bashkëpunimi, detyrimet për raportim, etj.).
  - kaktimi i një administratori ose një anëtar të Këshillit Drejtues si personel i dedikuar për administrimin dhe kontrollin e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, të ndryshëm nga funksioni i kontrollit të brendshëm, dhe siguron një ndarje të përshtatshme të detyrave dhe përgjegjësiave.
11. Në përputhje me nenin 13(3) të Rregullores “Mbi parimet bazë të administrimit të bankave” dhe paragrafin 33.3 të Udhëzimit “Për qeverisjen e brendshme dhe efektive të bankave”, banka siguron që funksionet e përfshira në administrimin e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, veçanërisht për funksionin e kontrollit të brendshëm, të kenë burime të mjaftueshme, njerëzore dhe financiare dhe të kenë status dhe autoritet të mjaftueshëm për të përmbushur rolin e tyre në mënyrë efektive. Banka ofron mundësi trajnimi për stafin e saj të fokusuar në rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin dhe merr në konsideratë mundësinë e një trajnimi të përgjithshëm ndërgjegjësues për to.
12. Në përputhje me kërkesat e përgjithshme të Rregullores “Mbi parimet bazë të administrimit të bankave” dhe paragrafit 2.6 (Seksioni I<sup>4</sup>) të Udhëzimit “Mbi drejtimin e brendshëm dhe efektiv

<sup>3</sup> “Kriteret e përshtatshmërisë individuale dhe kolektive të anëtarëve të këshillit drejtues”.

<sup>4</sup> “Këshilli Drejtues”.

të bankave”, Këshilli Drejtues ushtron mbikëqyrje efektive mbi ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore dhe vlerëson ndikimin e strategjisë së biznesit në qëndrueshmërinë e objektivave të klimës dhe mjedisit.

13. Për të marrë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj rrezikut, duke marrë parasysh interesat afatgjata financiare të bankës, Këshilli Drejtues përgatit përgjigjen/reagimin e bankës ndaj rreziqeve të përgjithshme të lidhura me klimën dhe mjedisin, si dhe vendos objektiva të qëndrueshme në formën e një strategjie të lidhur me rreziqet financiare klimatike dhe mjedisore. Në këtë kuptim, banka integron rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin në kulturën e tyre të rrezikut.
14. Politikat dhe praktikat e shpërblimit kontribuojnë në një qasje afatgjatë për adresimin e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin. Banka vendos tregues që lidhen me klimën dhe financat e qëndrueshme në politikën e saj të shpërblimit dhe këta tregues i përfshin në strategjinë e biznesit dhe/ose në kuadrin e administrimit të rrezikut.
15. Banka integron rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin në sistemet e saj të raportimeve të brendshme, në përputhje me nenin 11, pika 3, shkronja “a”, të Rregullores “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave”, mbi ekspozimet ndaj rrezikut dhe profilin e saj të rrezikut. Sistemet e raportimit sigurojnë informacion të besueshëm, të plotë, objektiv dhe të vazhdueshëm për të gjitha nivelet përkatëse të administrimit në bankë për ndihmuar marrjen e vendimeve të biznesit. Në terma afatshkurtër, banka vlerëson nevojën për të dhëna nga njësitë e zhvillimit të strategjisë dhe administrimit të rrezikut, identifikon mangësitë e të dhënave dhe të formulon plane për adresimin e tyre dhe tejkalimin e çdo mangësie.
16. Kontrolli i brendshëm siguron që banka ka sisteme efektive dhe të besueshme të identifikimit, të raportimit dhe komunikimit të brendshëm e të jashtëm të të dhënave që mundësojnë grumbullimin e tyre për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin. Nisur nga natyra e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, banka vlerëson nevojën për të përshtatur sistemet e saj të informacionit për të qenë në gjendje të grumbullojë të dhënat e nevojshme për të vlerësuar ekspozimin e saj ndaj këtyre rreziqeve.

## **5. PRITSHMERITË MBIKËQYRËSE PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT**

### **5.1 Sistemi i Administrimit të rrezikut**

17. Banka ndërton një kuadër gjithëpërfshirës dhe të dokumentuar të ndikimit të rreziqeve klimatike dhe mjedisore mbi kategoritë ekzistuese të rrezikut. Rreziqet klimatike dhe mjedisore mund të konsiderohen si faktorë që prekin kategoritë ekzistuese të rrezikut, por

banka mund t'i trajtojë këto rreziqe edhe si një kategori rreziku më vete, për qëllime organizative ose analitike. Aneksi 1, jep shembuj të faktorëve që nxisin/ndikojnë në rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin dhe si përkthehen ato në kategoritë e tjera ekzistuese të rreziqeve.

Për shembull, ngjarjet ekstreme të motit (si p.sh. thatësira) mund të konsiderohen si një faktor që ndikon mbi rrezikun e kredisë në huadhënien për bujqësinë, ndërkohë që rreziqe të tjera fizike (psh. përmbytjet) mund të ndikojnë njëkohësisht mbi disa kategori rreziku (psh. mbi rrezikun e kredisë, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit).

Megjithatë, bankat mund t'i trajtojnë ato si pjesë e një kategorie rreziku më vete, të quajtur “ESG”, “rreziqe klimatike”, ose me të tjera emërtime.

18. Banka ndërmerr hapa për të përcaktuar nga ana sasiore rreziqet klimatike dhe mjedisore. Në përshtatje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, banka identifikon dhe përdor tregues sasiore dhe ndërmerr veprime korrigjuese për plotësimin e të dhënave të nevojshme.
19. Banka, sipas nenit 11 të Rregullores “Mbi parimet bazë të administrimit të bankave, merr në konsideratë nevojën për të rishikuar politikën e saj për administrimin e rrezikut dhe aktet e tjera të brendshme, të cilat në kuadër të rreziqeve klimatike dhe mjedisore përkufizojnë në detaje funksionet, sistemet, proceset, procedurat, aktivitetet dhe metodologjitë, ashtu si edhe kompetencat, përgjegjësitë (kolektive dhe individuale) dhe linjat e raportimit në të gjitha nivelet e strukturës organizative të bankës.
20. Banka, teksa rishikon oreksin/tolerancën e saj ndaj rrezikut, zhvillon tregues të përshtatshëm të rrezikut dhe të vendosin kufij të përshtatshëm për rreziqet klimatike dhe mjedisore, në nivel kundërpattie, sektorësh, zonash gjeografike, kur është e mundur. Banka monitoron dhe të publikon, në rastet kur është e mundur, politikën e saj për sektorët ekonomikë, ekspozimet gjeografike, të dhënat aktuale mbi ekspozimet ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore, bazuar mbi një kombinim të të dhënave historike dhe vlerësimeve në perspektivën e ardhshme (*forward-looking*), sipas kreut 6 “Pritshmëritë mbikëqyrëse për publikimin e informacionit” të këtij dokumenti.

## 5.2 Administrimi i rrezikut të kredisë

21. Referuar nenit 9 të Rregullores 62/2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (këtu e më poshtë, Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”), banka zhvillon strategjinë e saj të brendshme të rrezikut të kredisë dhe procedurat përkatëse lidhur me rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin. Banka ndërton politikat dhe procedurat e saj për të marrë përsipër ekspozime të qëndrueshme nga ana mjedisore, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe politikën e saj të përgjithshme mbi financat e

qëndrueshme. Përcaktimi i qëndrueshmërisë mjedisore të kredidhënies kërkon zhvillimin e një bashkësie kriteresh të reja të brendshme, ose përfshirjen e standardeve ekzistuese ose të ardhshme, në politikën e rrezikut të kredisë dhe strategjinë e kredidhënies.

22. Banka merr në konsideratë rreziqet klimatike dhe mjedisore në të gjithë ciklin e jetës së një kredie, që në momentin e parë të miratimit të një kredie dhe në vazhdimësi në monitorimin e profilit të rrezikut të kredimarrësit.
23. Banka, për klientët korporatë, në procesin e kredidhënies dhe të administrimit të rrezikut, konsideron të paktën sa më poshtë:
  - (i) objektivat e qëndrueshmërisë së klientit; (ii) ekspozimin e klientit ndaj rreziqeve fizike dhe atyre të tranzicionit dhe (iii) planet e zbutjes së rrezikut të ndryshimeve klimatike. Banka mund t'i përfshijë këto aspekte në sistemet e brendshme të vlerësimit të rrezikut të kredisë (*ratings*), për të zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi ndikimin që mund të kenë planet e përputhshmërisë së klientit me faktorët klimatikë dhe mjedisorë, mbi rrezikun e tij të kredisë.
24. Banka, përveç miratimit të ekspozimit, analizon qëllimin për të cilin do të përdoret kredia, dhe në veçanti, nëse kredia është përdorur për të financuar aktivitete të qëndrueshme apo të paqëndrueshme nga ana mjedisore, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga banka, si pjesë e politikës së saj të rrezikut të kredisë. Banka ia kërkon këtë informacion klientëve të saj, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe e përditëson atë rregullisht. Për më tepër, procesi i administrimit të rrezikut të kredisë kërkon gjithashtu procedura dhe metodologji përmes të cilave banka mund të verifikojë se kredia është përdorur për të financuar aktivitete të qëndrueshme, në të cilat përfshihet sa vijon:
  - a) mbledhja e informacionit lidhur me objektivat klimatike dhe mjedisore, ose ndryshe të objektivave të biznesit të kredimarrësve.
  - b) vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve të financimit të kredimarrësve me projekte apo aktivitete që kualifikohen të qëndrueshme nga ana mjedisore dhe kriteret e lidhura me to.
  - c) vlerësimi që kredimarrësit kanë gadishmërinë dhe aftësinë për të monitoruar dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme shpërndarjen e të ardhurave në drejtim të projekteve apo aktiviteteve që kualifikohen të qëndrueshme nga ana mjedisore.
25. Banka, për kreditë ndaj entiteteve të tjera ligjore, kërkon informacionin mbi përdorimin e kredive të tyre, përpara miratimit, për të vlerësuar nëse do të përdoret për veprimtari ekonomike që kualifikohen të qëndrueshme nga ana mjedisore ose, të paktën, kredia nuk do të përdoret për të financuar aktivitete ekonomike që nuk kualifikohen të qëndrueshme nga ana mjedisore. Banka merr në konsideratë ekspozimin ndaj rreziqeve fizike dhe tranzicionit për klientët, të cilët janë të përqëndruar në rajone ose vepronë në sektorë të caktuar që banka i konsideron veçanërisht të ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve.
26. Banka, për kreditë ndaj individëve, sigurohet që, referuar përkufizimit të një produkti si “i qëndrueshëm” (p.sh. “kreditë e gjelbra”), karakteristikat e kredisë të jenë në përputhje me

përkufizimin e produktit dhe që fondet të përdoren në mënyrën e duhur. Banka vlerëson gjithashtu ekspozimin ndaj rreziqeve fizike të klientëve që konsiderohet të jenë veçanërisht të ekspozuar ndaj rrezikut fizik (p.sh. ata që jetojnë në zona me rrezik të lartë të përmblyjeve).

27. Banka bën vlerësimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore të klientëve si përpara ashtu edhe pas miratimit të kredisë. Kjo konsiderohet praktikë e mirë nëse kjo përfshin mbledhjen dhe verifikimin e informacionit dhe të të dhënave të nevojshme për të vlerësuar ndjeshmërinë e kredimarrësve ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore, në mënyrë të veçantë përpara sesa të hyjnë në një marrëdhënie kredie ose të bëjnë një ndryshim të konsiderueshëm të saj, në përputhje me politikat dhe procedurat e bankës, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe në natyrën e aktivitetit të tij. Përveç kësaj, banka duhet të jenë të vetëdijshme mbi qëndrimet e klientëve të tyre lidhur me administrimin e këtyre ndikimeve dhe rreziqeve.

Për shembull, banka mund të marrë në konsideratë përdorimin e metodave analitike, që evidentojnë rreziqet klimatike dhe mjedisore për çdo sektor ekonomik. Për kreditë ose kredimarrësit të ekspozuar më shumë ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore, kërkohet një analizë më gjithëpërfshirëse e modelit të biznesit të kredimarrësit, duke përfshirë një rishikim të emetimeve globale të gazit serë (GS), aktuale dhe të parashikuara, mjedisin e tregut, kërkesat rregullative për mjedisin, një analizë të ndikimit të mundshëm të këtij udhëzuesi lidhur me aspektet mjedisore të pozicionit financiar të kredimarrësit.

28. Banka merr në konsideratë rreziqet klimatike dhe mjedisore kur vlerëson kolateralin duke qenë se këto rreziqe mund të prekin vlerën e kolateralit.

Për shembull, në këtë aspekt, rekomandohet që banka të marrë në konsideratë vendndodhjen e pronës tregtare apo rezidenciale, karakteristikat e saj teknike dhe energjetike, eficiencën e sistemeve inxhinierike, mekanike, etj.

29. Banka pasqyron rreziqet klimatike dhe mjedisore në kuadrin e vendosjes së çmimit të rrezikut të kredisë, dhe këto pasqyrohen në oreksin/tolerancën e saj ndaj rrezikut të kredisë (psh, duke specifikuar limite rreziku, kufinj tolerance dhe pragjet e rrezikut) dhe gjithashtu në strategjinë e biznesit.

Për shembull, si pjesë e përkufizimit të strategjisë së saj të biznesit dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, banka mund të zgjedhë të zvogëlojë apo kufizojë ekspozimet ndaj sektorëve që janë të dëmshëm për mjedisin ose klimën, ndërsa të rrisë ekspozimet ndaj sektorëve që kanë një ndikim pozitiv mbi mjedisin ose klimën.

Në këtë mënyrë, kuadri i vendosjes së çmimit pritet që të mbështesë perspektivën dhe strategjinë e zgjedhur të rrezikut, për shembull, duke diferencuar çmimin e kredive në përputhje me eficiencën energjetike të ekspozimeve, ose duke përdorur komisione të veçanta, sipas sektorëve apo klientëve.

Në përputhje me strategjinë e biznesit dhe oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, banka mund të konsiderojë gjithashtu inkurajimin e klientëve të saj për të mbajtur në vëmendjen e duhur rreziqet klimatike dhe mjedisore, me qëllim përmirësimin e aftësisë paguese dhe të qëndrueshmërisë ndaj këtyre rreziqeve. Kjo mund të përfshijë, për shembull, ofrimin e një norme të ulët interesi për një kredi të qëndrueshme për mjedisin ose lidhjen e normës së interesit të një kredie me një objektiv qëndrueshmërie që duhet të arrihet nga klienti. Klient i cili kontribuon ose është në përputhje me objektivat e përgjithshme lidhur me ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.

Sipas oreksit/tolerancës ndaj rrezikut të kredisë, banka përcakton tregues rreziku për rreziqet klimatike dhe mjedisore, në veçanti për rreziqet fizike dhe ato të tranzicionit. Gjithashtu, banka duhet t'i përcaktojë treguesit e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe kufijtë e rrezikut bazuar mbi nivelin e rrezikut që banka dëshiron të ndër marrë brenda profilit të saj të rrezikut, në përputhje me modelin e saj të biznesit.

30. Banka monitoron dhe administron rreziqet klimatike dhe mjedisore në portofolin e saj të kredisë, bazuar në kërkesat e përgjithshme të Rregullores “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë”, për shembull përmes analizës së përqendrimit dhe *stress testing*. Për shembull, banka monitoron dhe administron rrezikun e përqendrimit duke menaxhuar përqendrimet brenda llojeve të rreziqeve financiare që lidhen me klimën dhe mjedisin, si ekspozimi ndaj sektorëve të caktuar të ekonomisë apo zonave të caktuara gjeografike.

### 5.3 Administrimi i rrezikut operacional

31. Banka vlerëson ndikimin e rreziqeve fizike që rrjedhin nga ndryshimet klimatike mbi vetë operacionet e saj, duke përfshirë aftësinë për të rifituar me shpejtësi mundësinë për të vazhduar të ofrojnë shërbime. Vendndodhja gjeografike në të cilën vepron një bankë, mund ta bëjë atë më të prekshme ndaj rreziqeve fizike. Kjo vlen veçanërisht për shërbimet që nënshkruhet marrëveshje me palë të treta dhe aktivitetet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, veçanërisht nëse ofruesit e shërbimeve janë të vendosur në zona me rrezik më të lartë të ngjarjeve ekstreme të motit ose cënueshmëri të tjera të natyrës mjedisore.

32. Banka, në mënyrë të veçantë, ndërkohë që vlerëson funksionet kritike, konsideron ndikimin nga ndryshimi i klimës në ofrimin e këtyre funksioneve/shërbimeve. Në rastet kur rezultati është i rëndësishëm (material) për ndonjë linjë biznesi ose për veprimet e bankës në tërësi, rekomandohet që ai të reflektohet në planin e vazhdimësisë së veprimtarisë së bankës.
33. Në një këndvështrim më të gjerë, banka konsideron masën e ndikimit në rrezikun reputacional të natyrës së aktiviteteve që kryejnë. Banka, me qëllim të shmangies së rreziqeve ligjore dhe reputacionale që lidhen me rreziqet klimatike dhe mjedisore, vlerëson nëse produktet e investimit janë në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Për shembull, një bankë që është e përfshirë në financimin e aktiviteteve që janë të dënueshme publikisht (si p.sh. financimi i lëndëve djegëse fosile, financimi i një kompanie që është akuzuar se thyen rregullat mbi përdorimin e punës së fëmijëve apo punës së detyruar, etj.), mund të vërejë një ndikim mbi reputacionin e saj, ose mund të jetë subjekt rreziqesh ligjore.

34. Përveç sa më lart, konsiderohet me rëndësi që banka të pakësojë ndikimin negativ në klimë dhe në mjedis. Duke punuar në mënyrë aktive për të pakësuar ndikimin negativ në klimë dhe në mjedis, banka jo vetëm që mund të harmonizohet me marrëveshjet ndërkombëtare që synojnë zbutjen e ndryshimeve klimatike, por edhe zbut rreziqet e reputacionit që lidhen me papërgjegjshmërinë mjedisore. Për këtë arsye, konsiderohet praktikë e mirë që banka vepron në një sistem administrimi mjedisor që është në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare. Për më tepër, duke matur dhe duke synuar të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme performancën e saj mjedisore me kalimin e kohës, banka shfaq përkushtimin e saj të vazhdueshëm ndaj aktiviteteve të qëndrueshme.

- a) Për sa u takon emetimeve globale të gazrave serë, propozohet si më poshtë:
- i. Matja e emetimeve të drejtpërdrejta nga aktivitetet e veta (Objektivi 1)<sup>5</sup>.
  - ii. Matja e emetimeve jo të drejtpërdrejta, që lidhen me energjinë e blerë (Objektivi 2).
  - iii. Matja e emetimeve të tjera jo të drejtpërdrejta (Objektivi 3), me emetimet e financuara që lidhen më shumë me administrimin e rrezikut të kredisë dhe të tregut sesa me administrimin e rrezikut operacional.
- b) Për sa u takon ndikimeve të tjera mjedisore të operacioneve dhe masave për t'i pakësuar ato, rekomandohet si më poshtë:
- i. Futja dhe promovimi i përdorimit të metodave elektronike të pagesës.
  - ii. Pakësimi i përdorimit të letrës për klientin dhe/ose kontraktimin e produktit, duke promovuar përdorimin e mediave digjitale.
  - iii. Iniciativa të tjera që lidhen me operacionet e veta, së bashku me treguesit e performancës mjedisore.
- c) Për sa i takon ndikimit negativ në klimë dhe në mjedis, propozohet si më poshtë:
- i. Pakësimi i përdorimit të letrës dhe ujit, si në selinë qendrore ashtu edhe në degët e bankës.
  - ii. Promovimi i punës në distancë me qëllim pakësimin e lëvizjeve të punonjësve dhe përdorimin e makinave dhe të mjeteve të tjera të transportit.
  - iii. Sigurimi i kontratave afatgjata me furnizuesit e energjisë elektrike duke siguruar burime të rinovueshme të energjisë.
  - iv. Mënyra të tjera që sigurojnë pakësimin e ndikimit negativ në klimë dhe në mjedis, ose kontribuojnë në luftën kundër saj.

## 5.4 Administrimi i rrezikut të tregut

35. Lidhur me administrimin e rrezikut të tregut, banka merr në konsideratë faktin se rreziqet klimatike dhe mjedisore mund të çojnë në zhvendosje të ofertës dhe kërkesës për instrumentet financiare (p.sh. letra me vlerë, derivatet), produktet dhe shërbimet, të cilat mund të ndikojnë në vlerën e tyre.
36. Bankat që investojnë në kompani me modele biznesi të cilat vlerësohen si të paqëndrueshme nga ana mjedisore, të vendosura në zona gjeografike të ekspozuara ndaj rreziqeve fizike, mund të pësojnë një rënie në vlerën e tyre të investimeve, si rezultat i masave të politikës,

<sup>5</sup> Informacion i detajuar mbi objektivat është i disponueshëm në standardet e Protokollit të GS:  
<https://ghgprotocol.org/>

ndryshimeve në ndjesinë e tregut ose në teknologji, apo si rezultat i ndryshimeve graduale të pafavorshme të ngjarjeve të motit ose kushteve klimatike të rënduara.

37. Në të vërtetë, rëndësia e qëndrueshmërisë mjedisore dhe qëndrimit të qeverisjes gjithëpërfshirëse bëhet e dukshme kur instrumentet financiare të emetuara nga kompani që operojnë në sektorë që vlerësohen si të paqëndrueshëm nga ana mjedisore, pësojnë një rënie të papritur të vlerës.

## 5.5 Administrimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit

38. Banka mer në konsideratë nëse rreziqet klimatike dhe mjedisore ndikojnë mbi pozicionin e saj të likuiditetit ose të burimeve të financimit. Në rastet kur këto rreziqe konsiderohen të rëndësishme (materiale), sipas nenit 12 të Rregullores 14/2009 “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, banka ndërmerr hapa për të identifikuar, vlerësuar dhe administruar ndikimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore mbi pozicionin e saj të likuiditetit dhe të burimeve të financimit, përgjatë horizonteve të përshtatshme kohore dhe për të ruajtur rezerva të përshtatshme të likuiditetit, brenda kuadrit ligjor dhe rregullativ mbi matjen dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit.
39. Vlerësimi i pikës më lart kryhet në perspektivën e ardhshme (*forward-looking*), duke supozuar njëkohësisht kushte të zakonshme biznesi dhe kushte të pafavorshme dhe, në veçanti, konsiderohen skenarë të ashpër, por të mundshëm, të cilët mund të ndodhin të kombinuar mes tyre, duke vënë theksin mbi ngjarjet kryesore që çojnë pozicionin e likuiditetit duke vlerësuar ndikimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore dhe materialitetin e tyre mbi pozicionin e likuiditetit ose mbi burimet e financimit të bankës.

Nga njëra anë faktorët klimatikë dhe mjedisorë mund të ndikojnë vlerën e aktiveve financiare mundësinë e tregtimit të tyre, duke krijuar në këtë mënyrë rrezik afatshkurtër të likuiditetit. Ky rrezik gjithashtu mund të shfaqet si rezultat i ngjarjeve klimatike ose mjedisore që shkaktojnë një tërheqje të depozitave të bankës psh. krizat mjedisore të tilla si trazirat sociale, mund të çojnë në tërheqje më të mëdha fondesh nga publiku, ose të krijojnë vështirësi në pozicionin e likuiditetit të bankës që ndodhet në një zonë të veçantë gjeografike.

Nga ana tjetër, faktorët klimatikë dhe mjedisorë mund të prekin disponueshmërinë dhe/ose stabilitetin e burimeve të financimit (p.sh. rritje të normës së interesit, depozita të paqëndrueshme për shkak të ndryshimit të preferencave të klientit, etj.), duke krijuar në këtë mënyrë rrezik afatmesëm ose afatgjatë të financimit. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të njihet efekti potencial i problemeve reputacionale mbi financimin e bankave.

## 5.6 Analiza e skenarëve dhe *stress test*-et

40. Banka vlerëson rreziqet klimatike dhe mjedisore përmes përdorimit të analizës së skenarëve dhe/ose *stress test*-eve. Në këtë kuptim, duhet nënvizuar se, ndryshe nga *stress test*-et tradicionale, ndikimet më të dëmshme të rreziqeve klimatike dhe mjedisore ka më shumë mundësi të ndodhin në një periudhë afatmesme deri afatgjatë dhe për këtë arsye për këto ushtrime do të nevojitet një horizont kohor mjaft më i gjatë.
41. Banka, merr në konsideratë përdorimin e skenarëve që janë në përputhje me trajektorët shkencorë të ndryshimit të klimës, të tilla si skenarët e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC), apo skenarët e parashikuar nga Rrjeti për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS) për ndryshimet klimatike. Banka merr në konsideratë të paktën aspektet e mëposhtme, ndërkohë që kryen analizën e ndjeshmërisë të skenarëve dhe *stress test*-et për sa u takon rreziqeve klimatike dhe mjedisore:
- Mënyrën e ndikimit të bankës nga rreziku fizik dhe rreziku i tranzicionit.
  - Mënyrën e evoluimit të rreziqeve klimatike dhe mjedisore, sipas skenarëve të ndryshëm, duke marrë në konsideratë veçoritë e këtij lloji të rrezikut (pasiguria dhe mungesa e linearitetit, probabiliteti që nuk mund të bazohet mbi të dhënat historike, ndikimet potencialisht ekstreme dhe të përhapura gjerësisht).
  - Mënyrën e ndodhjes së rreziqeve klimatike dhe mjedisore në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në varësi të skenarëve që merren në konsideratë.
42. Banka përcakton profilin e saj të rrezikut, dhe supozimet lidhur me tiparet e tij specifike, si dhe rekomandohet shqyrtimi i disa skenarëve dhe/ose kombinime të tyre. Banka, në kuadrin e planifikimit të kapitalit, vlerëson mjaftueshmërinë e kapitalit mbi një skenar bazë të besueshëm dhe skenarë të rënduar, specifikë për bankën. Banka supozon ngjarje të jashtëzakonshme por të mundshme, me një ashpërsi të mjaftueshme në terma të ndikimit të tyre mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, sipas nenit 17, paragrafi 1, të Udhëzimit Nr.60, datë 04.09.2019 të ndryshuar “Për *stress test*-et e bankave”.
43. Banka interpreton rezultatet e *stress test*-eve dhe, nëse është e nevojshme, ndërmerr masa të qarta për zbutjen e rrezikut të tyre. Programet e *stress test*-eve komunikohen në mënyrë efektive në të gjitha linjat e dhura të biznesit dhe tek drejtuesit ekzekutivë, me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi mbi rrezikun, të përmirësohet kultura e rrezikut dhe të lehtësohet dialogu brenda bankës mbi masat e mundshme të administrimit të rrezikut.

## 6. PRITSHMËRITË MBIKËQYRËSE PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT

44. Banka publikon informacionin mbi rreziqet financiare lidhur me ndryshimet klimatike dhe mjedisore bazuar në materialitetin e tyre, sipas përcaktimeve të rregullores nr. 60 datë 29.08.2008 “Kërkesat minimale të publikimit të informacionit”.
45. Në rastet kur banka nuk i konsideron materiale rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin dhe nuk publikon informacion mbi to, banka e dokumenton këtë vendim me informacion cilësor dhe sasior në mbështetje të vlerësimit.
46. Në rastin kur, banka konsideron materiale rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin publikon informacion mbi ekspozimet e saj, si dhe masat e marra për të administruar dhe zbutur këto rreziqe. Në informacionin e publikuar banka publikon metodat, përkufizimet dhe kriteret e përdorura në vlerësimin dhe raportimin e të dhënave të tilla.
47. Banka ndjek parimin e proporcionalitetit në publikimin e informacionit mbi emetimet e gazrave serë që ato financojnë si dhe emetimin e gazrave nga vetë banka. Këtë informacion e publikon duke detajuar edhe mënyrën e matjes së emetimit.

Për shembull, kjo mund të kërkojë një qasje për matjen e intensitetit të karbonit për çdo ekspozim, në portofole të mëdha të korporatave, një matje të konsumit aktual të energjisë për pronat e vetë bankës, ose një vlerësim të efikasitetit energjetic të portofoleve në pronësi të saj.

48. Banka angazhohet për të kontribuar në arritjen e ndryshimit të përgjithshëm klimatik dhe objektiva të qëndrueshme mjedisore. Banka ofron informacion gjithëpërfshirës dhe kuptimplotë sesi aktiviteti i biznesit ka ndikim në objektivat mjedisore në tërësi. Informimi se si banka kontribuon në ndryshimin e klimës dhe objektivave mjedisore, paraqet përkushtimin ndaj qëndrueshmërisë dhe shmang rrezikun e fasadës së gjelbër.
49. Publikimi i informacionit bëhet mbi baza periodike duke mbajtur në konsideratë zhvillimin e shpejtë të informacionit të publikuar për rreziqet klimatike dhe mjedisore si dhe nevojat e palëve të interesuara të tregut mbi këtë fushë.
50. Banka e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti, e konsideron praktikë të mirë që të publikohet progresi mbi hapat e ndërmarrë, në lidhje me propozimet e lartpërmendura, në kontekstin e qëndrueshmërisë ose raporteve të integruara.

## 7. MODELET E RAPORTIMIT

51. Me publikimin e këtij dokumenti banka vlerëson përputhshmërinë e praktikës së saj aktuale të administrimit dhe publikimit të informacionit për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin dhe pritshmëritë të përcaktuara në këtë dokument. Banka përcakton përmirësimin e praktikave ekzistuese, nëpërmjet ndërtimit të një plani të përshtatjes dhe zbatimit të këtyre pritshmërive.

52. Për qëllime të këtij dokumenti banka raporton:

- a) Formularin e vetëvleresimit sipas aneksit 2 të këtij dokumenti ku do të paraqiten praktikat e përshkruara në këtë dokument.
- b) Formularin e planit të veprimit sipas aneksit 3 të këtij dokumenti, ku paraqiten planet që synojnë adresimin në mënyrë progresive të këtyre pritshmërive.
- c) Formularin për ndjekjen e statusit të planit të veprimit sipas aneksit 4 të këtij dokumenti.

## 8. ANEKSE

### 8.1 Aneksi 1: Shembuj të faktorëve që nxisin rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe mjedisin dhe si ato ndikojnë në kategoritë e tjera ekzistuese të rreziqeve.

Rreziqet	Fizike		Të tranzicionit	
	Të lidhura me klimen	Të lidhura me mjedisin	Të lidhura me klimen	Të lidhura me mjedisin
	<p>Shembuj të ngjarjeve akute:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thatësira</li> <li>• Përmytje</li> <li>• Stuhi</li> <li>• Valët e të nxehtit</li> <li>• Rrëshqitje toke</li> <li>• Zjarre</li> <li>• Tërmete</li> </ul> <p>Shembuj të ngjarjeve kronike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet ekstreme të motit</li> <li>• Acidifikimi i oqeanëve</li> <li>• Rritja e temperaturave</li> <li>• Rritja e nivelit të detit</li> <li>• Ndryshimi i modeleve të reshjeve</li> </ul>	<p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndotja e ajrit</li> <li>• Ndotja e ujit</li> <li>• Ndotja e tokës</li> <li>• Degradimi i cilësisë së tokës</li> <li>• Shkretëtirëzimi</li> <li>• Shpyllëzimi</li> <li>• Humbja e biodiversitetit</li> <li>• Mungesa e burimeve</li> </ul>	<p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Politika, legjislatiioni dhe ndryshimet rregullative</li> <li>• Çmimi i karbonit</li> <li>• Ndryshimet teknologjike drejt zhvendosjes në alternativa teknologjike me të gjelbra</li> <li>• Zhvendosja e preferencave të konsumatorëve dhe e tregut drejt alternativave të gjelbra.</li> </ul>	<p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Politika, legjislatiioni dhe ndryshimet rregullative <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontrolli i ndotjes</li> <li>- Kontrolli i pesticideve</li> <li>- Masat për ruajtjen mjedisit</li> </ul> </li> <li>• Ndryshimet teknologjike drejt zhvendosjes në alternativa teknologjike me të gjelbra</li> <li>• Zhvendosja e preferencave të konsumatorëve dhe e tregut drejt alternativave të gjelbra.</li> </ul>
<b>Rreziku i kredisë</b>	<p>Aftësia për të paguar apo shyerja e ekspozimit, mund të ndikohet për shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nga reduktimi i të ardhurave pas një ngjarjeje klimatike (psh, rritja e kostove për tu përshtatur me teknologji të reja, apo rritja e investimeve, rrit shpenzimet dhe ul te ardhurat. Kjo mund të ndikojë në aftësinë pagese dhe në aksesin më të kufizuar për financim).</li> <li>• rënia e vlerës së kolateralit në portofolet e pasurive të paluajtshme si rezultat i rritjes së rrezikut nga përmytjet/ pronave të dëmtuara/ rendimentet më të ulëta në kulturat ushqimore.</li> </ul>		<p>Masat e tranzicionit mund të shkaktojnë kosto të konsiderueshme përshtatjeje dhe përfitueshmëri më të ulët, e cila mund të ndikojë aftësinë për të shlyer detyrimin si dhe në rënien e vlerës së kolateralit.</p>	
<b>Rreziku i tregut</b>	<p>Ngjarjet që ndikojnë në rreziqet fizike mund të bëhen shkak për ndryshime të papritura në riciminin e investimeve apo të ndryshimeve në luhatshmërinë e normave të interesit.</p>		<p>Ngjarjet që ndikojnë në rreziqet e tranzicionit mund të ndikojë në ndotje të larta dhe në emetime të mëdha të karbonit të cilat cojnë në ricmime të letrave me vlerë dhe të derivativëve që lidhen me industri të tilla.</p>	
<b>Rreziku operacional</b>	<p>Ngjarjet ekstreme të motit mund të shkaktojnë dëme në pronat e bankave, si degët dhe qendrat e të dhënave, që mund të ndikojnë në ndërprerje të funksionimit të tyre.</p>		<p>Zhvendosja e preferencave të tregut në lidhje me çështjet klimatike mund të çojë në ekspozim ndaj rrezikut reputacional dhe të</p>	

		përbushjes së detyrimeve nga ana e bankave, si rezultat i financimeve të tyre të aktiviteteve të diskutueshme mjedisore.
<b>Rreziqe të tjera: likuiditetit dhe modeli i biznesit</b>	Ngjarjet që ndikojnë në rreziqet fizike mund të ndikojnë kundërparti të caktuara dhe ti detyrojnë ato të tërheqin fondet e tyre për të riparuar dëmet e shkaktuara nga ngjarje të tilla.	Ngjarjet që ndikojnë në rreziqet e tranzicionit mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e disa linjave të biznesit dhe çojnë në rrezik strategjik për modele specifike biznesi.  Likuiditeti i bankave mund të ndikohet nga një rëqimim i papritur i letrave me vlerë për shkak të faktorëve të rrezikut të tranzicionit.

## 8.2 Aneksi 2: Vetëvlerësimi: formulari dhe udhëzime

53. Ky aneks i siguron bankës një model të standardizuar dhe udhëzime që ajo duhet të ndjekë për të raportuar në Bankën e Shqipërisë lidhur me informacionin mbi çdo shmangie ekzistuese në praktikat e bankës nga pritshmëritë mbikëqyrëse të përshkruara në këtë dokument:

Seksioni	Nën-seksioni	Përshkrimi i statusit të bankës	Statusi i përputhshmërisë së bankës	Komente të tjera	# mangësi
<b>3. Pritshmëritë mbikëqyrëse për modelin e biznesit dhe strategjinë</b>	-				
<b>4. Pritshmëritë mbikëqyrëse për qeverisjen e brendshme</b>	-				
<b>5. Pritshmëritë mbikëqyrëse për administrimin e rrezikut</b>	<b>5.1. Sistemi i administrimit të rrezikut</b>				
	<b>5.2. Administrimi i rrezikut të kredisë</b>				
	<b>5.3. Administrimi i rrezikut operacionial</b>				
	<b>5.4. Administrimi i rrezikut të tregut</b>				
	<b>5.5. Administrimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit</b>				

Seksioni	Nën-seksioni	Përshkrimi i statusit të bankës	Statusi i përputhshmërisë së bankës	Komente të tjera	# mangësi
	5.6. Analiza e skenarit dhe stress testing				

54. Në plotësimin e tabelës së mësipërme, banka merr parasysh përkufizimet e mëposhtme për informacionin e kërkuar:

- **Seksioni:** kjo kollone e tabelës i referohet seksioneve 3 deri në 5 të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë për rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin. Nuk modifikohet nga banka.
- **Nënseksioni:** Kjo kollone e tabelës referohet, kur është e zbatueshme, nënseksioneve të seksioneve 3 deri në 5 më sipër nga udhëzimet/rekomandimet e Bankës së Shqipërisë për rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin. Nuk modifikohet nga banka.
- **Përshkrimi i statusit të bankës:** Banka përfshin këtu një përshkrim të situatës aktuale të saj në lidhje me përputhshmërinë (mospërputhjen), si dhe çdo plan specifik që do të zbatohet për të përmbushur rekomandimet e përcaktuara në çdo seksion ose nënseksion specifik siç përshkruhet në këtë dokument.
- **Statusi i përputhshmërisë së bankës:** Përdoret një shkallë me 3 nivele ku banka do të tregojë, sipas vetëvlerësimit të saj, nivelin e përputhshmërisë në çdo seksion ose nënseksion specifik:
  - **Nivel i lartë përputhshmërie:** banka përmbush plotësisht pritshmëritë e përcaktuara në këtë dokument në lidhje me seksionin ose nënseksionin specifik, ose ka pak aspekte me rëndësi të ulët për t'u përmirësuar dhe ka plane veprimi që janë në fuqi për të siguruar përputhshmëri në një periudhë shumë të shkurtër kohore.
  - **Nivel i ulët përputhshmërie:** banka përmbush pjesërisht pritshmëritë e përcaktuara në këtë dokument në lidhje me një seksion ose nënseksion të caktuar, ose banka nuk përmbush asnjë nga pritshmëritë ose rekomandimet dhe ka plane veprimi për përmbushjen e tyre.
  - **Jo në përputhje:** banka nuk përmbush asnjë nga pritshmëritë e përcaktuara në këtë dokument në lidhje me një seksion ose nënseksion të caktuar dhe nuk ka asnjë plan veprimi në fuqi që banka të jetë në përputhje ose pjesërisht në përputhje në një periudhë shumë të shkurtër kohore.

*“Banka do të ketë parasysh se ajo pret që të zhvillojë dhe zbatojë veprime për secilën nga mangësitë e evidentuara në këtë vetëvlerësim”.*

- **Komente të tjera:** Çdo koment tjetër që banka mund ta konsiderojë të rëndësishëm për t'u shënuar në lidhje me statusin e saj, veprimet që duhen zbatuar, çdo plan tashmë në zhvillim ose zbatim, etj.
- **# mangësi:** Një identifikues numerik (d.m.th., 1, 2, 3, etj.) i lidhur me një mangësi të caktuar që banka duhet ta lidhi me një mangësi të caktuar. Identifikues i ndryshëm numerik duhet të shoqërohet me mangësi të ndryshme

### 8.3 Aneksi 3. Plani i veprimit: formularë dhe udhëzime

55. Ky aneks u siguron bankave një model të standardizuar dhe udhëzime që ato duhet të ndjekin për të raportuar në Bankën e Shqipërisë me angazhimet e ndërmarra që synojnë të adresojnë në mënyrë progresive shmangiet nga pritshmëritë e përcaktuara në këtë dokument:

# Veprimi që do të zbatohet	Përshkrimi i veprimit që do të zbatohet	# mangësi(të)	Kompleksiteti	Pengesa të mundshme	Afati i parashikuar, që të zbatohet plotësisht	Objektivat e zbatimit për vitin e 1-rë	Objektivat e zbatimit për vitin e 2-të <sup>6</sup>	Objektivat e zbatimit për > 2 vjet <sup>7</sup>
...								

56. Në plotësimin e tabelës së mësipërme, banka merr parasysh përkufizimet e mëposhtme për informacionin e kërkuar:

<sup>6</sup> Aplikohet vetëm në rast se koha e zbatimit të veprimit të propozuar është më e gjatë se afati i referuar.

<sup>7</sup> Aplikohet vetëm në rast se koha e zbatimit të veprimit të propozuar është më e gjatë se afati i referuar.

- **# Veprimi që do të zbatohet:** Një identifikues numerik (d.m.th., 1, 2, 3, etj.) i lidhur me një veprim të caktuar që do të zbatohet nga banka për të përmbushur (qoftë në periudhë afatshkurtër, ose afatmesme ose afatgjatë) rekomandimet nga udhëzimet e Bankës së Shqipërisë për rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin. Identifikues të ndryshëm numerikë pritet të shoqërohen me veprime të ndryshme në mënyrë që të mund të ndjekin evoluimin e veprimeve përgjatë raportimit vjetor të statusit nga secila bankë në Bankën e Shqipërisë. Banka duhet të marrë parasysh më shumë se një plan veprimi mund të shoqërojë një mangësi të vetme të identifikuar në vetëvlerësimin e mëparshëm.
- **Përshkrimi i veprimit që do të zbatohet:** Banka duhet të përfshijë këtu një përshkrim të planit të veprimit që do të zbatohet për të qenë në përputhje me rekomandimet e përcaktuara në çdo seksion ose nënseksion specifik, siç përshkruhet në këtë dokument. Referencat për fushat e përfshira, eksternalitetet etj., duhet të përfshihen nga banka në përshkrim.
- **# mangësi:** Banka këtu duhet të përfshijë numrin e identifikimit të të gjitha mangësive ("# mangësi") që një plan veprimi i caktuar pritet të ndihmojë në adresimin e problematikave/shmangieve të evidentuara. Banka mund të marrë parasysh që një plan veprimi mund të lidhet (ose të ketë ndikim) në një ose më shumë mangësi; dhe një ose më shumë mangësi mund të shoqërohen me një plan të caktuar veprimi.
- **Kompleksiteti:** Përdoret një shkallë me 3 nivele ku banka do të tregojë, sipas vetëvlerësimit të saj, nivelin e kompleksitetit të një veprimi të caktuar që do të zbatohet, duke ndjekur shkallën e mëposhtme:
  - **E ulët:** banka pret që veprimi të zbatohet në një periudhë të shkurtër kohore; një volum i ulët burimesh (d.m.th., personeli, parash, etj.) duhet të dedikohen për zbatimin e tij; dhe/ose asnjë vendim kritik nuk duhet të merret në nivel Këshilli Drejtues ose Asambleje e aksionereve.
  - **E mesme:** ato raste që nuk konsiderohen të jenë të një kompleksiteti të ulët apo të lartë.
  - **E lartë:** banka pret që veprimi të mos zbatohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme; një volum i madh burimesh (d.m.th., personeli, parash, etj.) duhet të dedikohen për zbatimin e tij; dhe/ose vendimet kritike duhet të merren në nivel Këshilli Drejtues ose Asambleje e aksionereve.
- **Pengesa të mundshme:** banka duhet të numërojë dhe shpjegojë shkurtimisht çdo pengesë të mundshme që mund të vonojë zbatimin e veprimit. Banka do të përfshijë gjithashtu çdo masë të mundshme zbutëse që ajo është gati të përcaktojë ose zbatojë.
- **Afati i pritshëm për t'u zbatuar plotësisht:** Afati i pritshëm i Bankës për zbatimin e plotë të një plani specifik. Kur raportojnë kuadrin kohor në vend të datave specifike, banka duhet të mos raportojë periudha më të gjata se 3 muaj (d.m.th., tremujori i parë i 2025 mund të konsiderohet i vlefshëm).
- **Objektivat e zbatimit për vitin e parë:** banka duhet të përfshijë këtu nënndarje të planit të përgjithshëm të veprimit, që do të zbatohen në 12 muajt pas datës së raportimit.

- **Objektivat e zbatimit për vitin e dytë:** Në ato raste kur koha e zbatimit pritet të zgjasë më shumë se 12 muaj, banka duhet të përfshijë këtu nënndarje të planit të përgjithshëm të veprimit, që pritet të zbatohen ndërmjet 12 dhe 24 muajve pas datës së raportimit.
- **Objektivat e zbatimit për >2 vjet:** Në ato raste kur koha e zbatimit pritet të zgjasë më shumë se 24 muaj, banka duhet të përfshijnë këtu nënndarje të planit të përgjithshëm të veprimit, që pritet të zbatohen duke filluar nga 24 muaj pas datës së raportimit.

#### 8.4 Aneksi 4. Monitorimi/Ndekja e planit të veprimit: formular dhe udhëzime

57. Ky aneks u siguron bankave një model të standardizuar dhe udhëzime që banka duhet të ndjekë për të raportuar në Bankën e Shqipërisë mbi statusin e planit të veprimit të përshkruar në Aneksin 2:

# Veprimi që do të zbatohet	Statusi i zbatimit (%)	Çdo ndryshim i bërë në afatin fillestar të pritshëm për tu zbatuar plotësisht	Përshkrimi i progresit që nga statusi i mëparshëm i raportimit	Hapat e mëtejshëm që do të zbatohen në 12 muajt në vijim	Komente të tjera

...					

58. Në plotësimin e tabelës së mësipërme, banka merr parasysh përkufizimet e mëposhtme për informacionin e kërkuar:

- **# Veprim që do të zbatohet:** Një identifikues numerik (d.m.th., 1, 2, 3, etj.) i lidhur me një veprim të caktuar që do të zbatohet nga banka për të përmbushur (qoftë në periudhë afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë) rekomandimet e këtij dokumenti. Identifikues të ndryshëm numerik pritet të shoqërohen me veprime të ndryshme në mënyrë që të mund të ndjekin zhvillimin e veprimeve përgjatë raportimit vjetor të statusit nga secila bankë në Bankën e Shqipërisë. Banka duhet të marrë parasysh se më shumë se një plan veprimi mund të shoqërohet me një mangësi të vetme të identifikuar në vetëvlerësimin e mëparshëm.
- **Statusi i zbatimit (%):** Një vlerësim nga banka, i kohës së shpenzuar, i veprimeve më specifike të ndërmarra, etj., mbi nevojat për zbatueshmërinë e plotë të veprimit të ndërmarrë. Vlerat do të variojnë ndërmjet 0% dhe 100%.
- **Çdo ndryshim i bërë në afatin fillestar të pritshëm për t'u zbatuar plotësisht:** Banka duhet të theksojë këtu çdo ndryshim të bërë (d.m.th., vonesa ose progres) në afatet e përcaktuara fillimisht për zbatimin e veprimit specifik. Pritet gjithashtu të përfshihet një vlerësim se si çdo vonesë ose progres mund të ndikojë në përbushjen/zbatimin e përgjithshëm të veprimit.
- **Përshkrimi i progresit që nga statusi i mëparshëm i raportimit:** banka duhet të përfshijë këtu çdo progres që lidhet me zbatimin e veprimit specifik që nga raportimi i statusit të mëparshëm. Banka do të përfshijë, të paktën, "hapat e ardhshëm që do të zbatohen në 12 muajt në vijim" të raportuara për të njëjtin aktivitet në vazhdimin e planit të mëparshëm të veprimit, ose në kategorinë "objektivat e zbatimit për vitin e parë" në rast se kjo është hera e parë që banka paraqet ndjekjen e planit të veprimit.
- **Hapat e mëtejshëm që do të zbatohen në 12 muajt në vijim:** Banka duhet të përfshijë këtu nënndarje të planit global/ të përgjithshëm të veprimit që pritet të zbatohen në 12 muajt pas datës së raportimit.

**Komente të tjera:** Çdo koment shtesë që banka mund ta konsiderojë të rëndësishëm për t'u shënuar në lidhje me statusin e zbatimit të planit të veprimit, çdo pengesë të mundshme, përmbushjen e afateve, modifikimet në përcaktimin fillestar të një veprimi të caktuar, etj.

Banka e Shqipërisë  
[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë, Shqipëri  
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11  
Faks: + 355 4 2419408  
[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)